

Deklarata e Privatesise e Deloitte CE per Klientet

Shenim: Informacioni i meposhtem eshte i aplikueshem dhe per perpunimin e te dhenave personale ne marredhenie me furnizuesin, kontraktorin dhe nenkontraktorin” .

Informacion per perpunimin e te dhenave personale ne marredheniet me klientin:

Perkufizime

“Deloitte” i referohet nje ose me shume Deloitte Touché Tohmatsu Limited, nje shoqeri private ne Mbretetere e Bashkuar e kufizuar me garanci (“DTTL”), rrjetit te saj te subjekteve anetare dhe entiteteve te tyre te lidhura. DTTL dhe secila nga subjektet e saj anetare jane entitete ligjerisht te ndara dhe te pavarura. DTTL (gjithashtu quajtur si “Deloitte Global”) nuk ofron sherbime per klientet.

“Deloitte Central Europe (Deloitte CE)” eshte nje organizate rajonale entitetesh e organizuar nen ombrellen e Deloitte Central Europe Holdings Limited, subjekt anetar i Central Europe of Deloitte Touché Tohmatsu Limited. Sherbimet ofrohen nga filialet dhe subjektet e kontrolluara te Deloitte Central Europe Holdings Limited, te cilet jane persona juridike te ndare dhe te pavarur.

“Kontrollues” nenkupton nje kontrollues ose nje kontrollues te dhenash (siç percaktohet ne Legjislacionin per Mbrojtjen e te Dhenave Personale).

“Perpunues” nenkupton nje perpunues te dhenash ose perpunues (siç percaktohet ne Legjislacionin per Mbrojtjen e te Dhenave Personale).

“Legjislacioni per Mbrojtjen e te Dhenave Personale” nenkupton legjislacionin si vijon, te zbatueshem aq sa eshte e mundur, kohe pas kohe: (a) ligjet kombetare qe implementojne Direktiven per Mbrojtjen e te Dhenave (95/46/EC) dhe Direktiven per Privatesine dhe Komunikimet Elektronike (2002/58/EC); (b) GDPR; dhe (c) çdo ligj tjetër kombetar te ngjashem mbi privatesine.

“GDPR” nenkupton Regulloren e Pergjithshme per Mbrojtjen e te Dhenave (EU) (2016/679).

“te Dhenat Personale” nenkupton çdo te dhene personale (siç percaktohet ne Legjislacionin per Mbrojtjen e te Dhenave Personale) perpunuar ne perputhje me ose si pjese e Sherbimeve.

“Marresi” nenkupton nje person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci ose nje organ tjetër, te cilit te dhenat personale i jane perhapur (siç percaktohet me tej ne Legjislacionin e Mbrojtjes se te Dhenave Personale).

Te Dhenat Personale te dhena nga klientet e Deloitte CE (“klientet”) ose te marra direkt nga anetaret e stafit dhe perfaqesuesit e tyre, perpunohen nga entiteti Deloitte CE qe ka nje marredhenie kontraktuale me klientin perkates, me qellim ose ne lidhje me sa vijon:

1. ofrimin e sherbimeve siç eshte rene dakord ne kontraten perkatese me klientin;
2. pajtueshmerine me kerkesat ligjore, rregullatore ose profesionale;
3. adresimin e kerkesave dhe komunikimeve nga autoritetet kompetente;
4. administrimin e kontratave, kontabilitetin financiar, pajtueshmerine e brendshme dhe analizen e rrezikut, si dhe qellimet e marredhenies me klientin;
5. perdorimin e sistemeve te aplikacioneve (te ruajtura jashte ose se brendshmi) per teknologjine e informacionit dhe sherbimet e sistemit te informacionit (e-mail/arkivim dhe te ngjashme) - kjo mund te perfshije edhe aplikacione te ruajtura ne *cloud*, me kusht qe percaktimi i te dhenave te sigurise dhe detyrimet e transferimit te te dhenave te jete kryer nga Legjislacioni i zbatueshem i Mbrojtjes se te Dhenave Personale ("**Qellimet**").

Te Dhenat Personale mund te perfshijne te dhena ne lidhje me perfaqesuesit e klientit, personelin, anetaret e ekipit te projektit, furnizuesit dhe kontraktuesit ("Subjektet e te Dhenave Personale"), si dhe te Dhenat Personale te perfshira ne informacionin e marre ne lidhje me kontraten.

Kontrollues:

Kontrolluesi eshte kryesisht entiteti Deloitte CE qe eshte pale ne kontraten e klientit.

Per Qellimet e tregura me lart, te Dhenat Personale mund te perhapen/transferohen dhe perpunohen nga Marresit e meposhtem e te Dhenave Personale:

Grupi i entiteteve Deloitte:

Ne perputhje me Qellimet e specifikuara ketu me lart dhe ne masen e nevojshme per ofrimin e Sherbimeve, te Dhenat Personale mund te perhapen tek nje Kontrollues tjetër brenda grupit te shoqerive Deloitte (<http://www2.deloitte.com/global/en/get-connected/global-office-directory.html>)

Nese kerkohet dhe transferimi i te Dhenave Personale pertej kufijve te vendit (duke perfshire edhe vendet jashte Bashkimit Evropian), atehere transferimi do te behet vetem ne rast se detyrimet e percaktuara nga Legjislacioni per Mbrojtjen e te Dhenave Personale per keto transferime jane permbushur (entiteti Deloitte do te veproje si nje Kontrollues tjetër).

Perpunues:

Perpunuesit e meposhtem perpunojne te Dhenat Personale per llogari te Kontrolluesit ne perputhje me Qellimet:

Nenkontraktoret (te miratuar nga klienti ne kontrate ose ndryshe)

Furnizuesit standard te sherbimeve te Deloitte CE:

Furnizuesit evropian standard te sherbimeve:

Billigence Europe Limited, me seli ne adresen: 12 Gough Square, Londer, EC4A 3DW,

Mbreteria e Bashkuar

Deloitte Advisory & Management Consulting Private Limited Company, Dózsa Gy út 84.C., 1068 Budapest, Hungari

Deloitte CZ Services s.r.o., Karolinská 654/2, 186 00 Prague 8, Republika Çeke
Deloitte CE Business Service Sp. z o.o., Al. Jana Pawla II 22, 00-133 Varshave, Poloni
Deloitte Central Europe Service Centre s.r.o., Karolinská 654/2, 186 00, Prague 8, Republika Çeke
Deloitte Global Services Limited, Hill House, 1 Little New Street, EC4A 3TR Londer, Mbreteria e Bashkuar
4C Hungary Kft., Budafoki út 14. I/1, Budapest, 1111, Hungari
con4PAS, s.r.o., Novodvorská 1010/14, 142 01 Prague 4 – Lhotka, Republika Çeke
MobileXpense, Rue des Colonies 11, 1000 Bruksel, Belgjike
SI-Consulting Sp. z o.o., Slezna Str. 118, 53-111 Wroclaw, Poloni

Furnizuesit jo-evropian standard te sherbimeve:

Meqenese perpunimi i te Dhenave Personale perfshin transferimin jashte Bashkimit Evropian (BE), te gjitha entitetet e meposhtme kane plotesuar Klauzolat Standarde Kontraktuale te miratuara nga BE me entitetin Deloitte me te cilin klienti ka hyre ne marredhenie kontraktuale, duke siguruar keshtu nje nivel te mjaftueshem te mbrojtjes se te Dhenave Personale siç kerkohet nga Legjislacioni i Mbrojtjes se te Dhenave Personale.

Deloitte Touche Tohmatsu Services, Inc., 30 Rockefeller Plaza, New York, 10112 – 0015, SHBA

Deloitte Support Services India Private Limited, RMZ Futura, Block B, 2nd Floor, Plot No. 14 & 15, Road No. 2, Hi-Tec City Layout, Madhapur, Hyderabad – 500 081, Telangana, Indi
Deloitte Tax LLP, 30 Rockefeller Plaza, New York, 10112 – 0015, SHBA (i zbatohet vetem shërbimeve te Taksva dhe GES)
Microsoft Corporation, One Microsoft Way, Redmond, WA 98052, SHBA

Kontrolluesit e te dhenave dhe perpunuesit e te dhenave perosnale do te vendosin masa mbrojtese teknologjike, fizike, administrative dhe procedurale, te gjitha ne perputhje me standardet e pranuar te industrise, me qellim qe te mbrojne dhe te sigurojne konfidencialitetin, integritetin ose aksesin e te Dhenave Personale te perpunuara. Masat mbrojtese do te parandalojne perdorimin e paautorizuar ose aksesin e paautorizuar ne te Dhenat Personale ose parandalimin e shkeljeve te te dhenave personale (incident i sigurise) ne perputhje me udhezimet, politikat e Deloitte CE dhe legjislacionin e zbatueshem per Mbrojtjen e te Dhenave Personale. Entitet Deloitte CE qe perpunojne te dhenave e klientit jane gjithashtu te certifikuar me ISO 27001 ([ISO/IEC 27001 Information security management](#)).

Perpunimi i te Dhenave Personale eshte i nevojshem per ofrimin e sherbimeve sipas kontrates.

Individet kane te drejte te kerkojne akses ne te dhenat e tyre personale dhe te korrigojne ose fshijne te dhenat e tyre personale (aty ku eshte e mundur), ose te kerkojne nje kufizim ne perpunimin ose te kundershtojne perpunimin, si dhe te drejten per transferimin e te dhenave. Te gjitha te drejtat e pershkruara ne kete paragraf mund te zbatohen duke derguar nje kerkese me poste elektronike tek kontrolluesi i te dhenave ne: CEprivacy@deloitte.com. Individet mund te adresojne edhe pyetjet e tyre ne lidhje me mbledhjen dhe perpunimin e te Dhenave Personale brenda Deloitte CE ne adresen e postes elektronike te treguar me lart.

Ata kane te drejte te depozitojne ankese prane nje autoriteti mbikeqyres ne vendin e banimit te tyre nese ata konsiderojne se perpunimi i te dhenave personale qe lidhen me to eshte ne kundertshtim me Legjislacionin per Mbrojtjen e te Dhenave Personale.